

UDHËZIM

NR.27, DATË 7.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 30.11.2007 “PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 2.11.2005, me propozimin e Komisionit *Ad-Hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 11 të udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje: “Miratimi i vlerave për artikujt që publikohen në bursën “Reuters”, si dhe në buletine të posaçme, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Të tillë artikuj janë:

- a) Artikujt që publikohen në bursën “Reuters”- oriz, sheqer, vaj ushqimor.
- b) Artikulli “Banane”, që publikohen në bursën “Reuters”.
- c) Autovetura, vlera e të cilave publikohet në buletin “Quattroroute”.
- d) Automjetet, vlera e të cilave publikohet në buletin “Tuttotrasporti”.
- e) Produktet e çelikut, që publikohen në revistën “Metal-Buleti”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

RIDVAN BODE

Fletore Zyrtare Nr.165 23 Dhjetor 2011